



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarsvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme - Kancelarija Generalnog Sekretara - Office of the Secretary General

Datë: 19/09/2024

Nr.: 120/2024

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7, 01 mars 2019), duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Neni 13, Pika 7, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë nxjerr:

VENDIM

Miraton regjistrin e dokumenteve publike

1. **Vendimet administrative** - Të gjitha vendimet e marra nga Ministria e Drejtësisë që kanë ndikim publik.
2. **Raportet vjetore** - Raporte që përshkruajnë aktivitetet dhe arritjet e Ministrisë së Drejtësisë.
3. **Strategjitë dhe politikat** - Dokumente që detajojnë planet strategjike dhe politikat e ndjekura nga ministria për përmirësimin e sistemit të drejtësisë.
4. **Rregulloret dhe udhëzimet administrative** - Çdo rregullore apo udhëzim që ka lidhje me funksionimin e institucioneve të drejtësisë.
5. **Buletinet dhe njoftimet publike** - Informacion zyrtar që i njofton qytetarët për ngjarje, aktivitete, dhe vendime të rëndësishme.
6. **Raportet e buxhetit dhe financave** - Dokumente që tregojnë shpenzimet dhe alokimet financiare të ministrisë.
7. **Konsultimet publike** - Dokumente që përfshijnë përgjigjet dhe rezultatet e konsultimeve të mbajtura me publikun.
8. **Vendimet gjyqësore që kanë ndikim në politikën e drejtësisë** - Nëse ka vendime që prekin çështje të politikës publike në sistemin e drejtësisë.

9. Obligohen zyrtarët përgjegjës që Regjistri të jetë i përditësuar çdo tre muaj dhe të jetë i qasshëm për publikun, duke mundësuar transparencë dhe përgjegjshmëri nga ana e institucioneve publike.



Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministres;
- ZSP-së;
- Departamentit Shërbime të Përgjithshme;
- Divozionit për Komunikim Publik;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.